

Nëse është e nevojshme ju keni të drejtën të përdorni shërbimet e një përkthyesi. Lutemi na informoni për kërkesat për një përkthyes kur caktoni vizitën tuaj. Personeli i kujdesit ndaj shëndetit do të organizojë një përkthyes nga një agjenci përkthimi.

Të dhënat tuaja të pacientit dhe informacioni personal

Informacioni i të dhënave të pacientit kërkohet në mënyrë që ju të trajtoheni në mënyrën e duhur dhe të sigurt. Ato kërkohen edhe për arsye të cilësisë, sigurisë së pacientit dhe kontrolle të mëtijshme. Informacioni që regjistrohet në të dhënat tuaja të pacientit përfshin ekzaminimet dhe trajtimet, cilat sëmundje keni pasur, si dhe informacion nëse ju jeni shtruar në spital ose jo.

Të dhënat gjithëpërfshirëse

Ne si personel i kujdesit për shëndetin përdorin të dhëna të gjithëpërfshirëse. Kjo do të thotë se personeli, në vendin ku ju po merrni kujdes mjekësor, kanë mundësinë të shikojnë të dhënat nga ofrues të tjerë të shëndetit - nga bordet e rretheve, bashkive dhe ofruesit privatë të kujdesit mjekësor. Qëllimi i kësaj gjëje është të lehtësojë një pamje gjithëpërfshirëse të historikut tuaj mjekësor dhe nevojave tuaj të kujdesit për shëndetin.

Vetëm personeli mjekësor që ka një marrëdhënie personel/pacient me ju mund të shikojë të dhënat tuaja për t'ju dhënë kujdes të duhur dhe të sigurt mjekësor. Kjo zbatohet pavarësisht faktit se në cilin bord rrethi, bashkie ose ofrues kujdesi shëndeti ju shkoni. Asnjë nga personeli i kujdesit të shëndetit nuk mund të lexojë të dhënat tuaja nga ofrues të tjerë mjekësorë pa miratimin tuaj të mëparshëm.

Ju keni të drejtën të qëndroni jashtë sistemit gjithëpërfshirës të të dhënave.

Opsioni për të bllokuar informacionin

Ju mund të zgjidhni ta bllokoni informacionin që nuk doni të jetë i disponueshëm për ofruesit e tjerë të kujdesit të shëndetit. Ju mund të kërkontë që informacioni të ç'bllokohet në çdo kohë. Për fëmijët dhe të rinjtë zbatohen rregulla të posaçme. Nëse ju jeni kujdestar nuk keni të drejtën të bllokoni informacionin tek të dhënat e fëmijës. Nëse jeni në moshën 18 vjeç mund të bllokoni informacionin vetë tek të dhënat tuaja, duke patur parasysh moshën në rritje dhe pjekurinë.

Kush i ka të dhënat e mia?

Vetëm personeli mjekësor i cili ka një marrëdhënie personel/pacient me ju mund të shikojë informacionin tek të dhënat tuaja. I gjithë personeli i kujdesit mjekësor është i detyruar të ruajë fshehtësinë profesionale për sa i përket mbikëqyrjes së paautorizuar dhe shpërndarjes. Personi që ka lexuar të dhënat tuaja mund të gjendet pas ngjarjes, dhe ju keni të drejtën të dini se kush janë ata. Bashkia e Rrethit bën kontrolle sistematike, të herë pas hershme e të

rastësishme të regjistrave të të dhënave. Kontaktoni Punonjësini tuaj të Mbrojtjes së të Dhënave nëse doni të merrni një listë se kush i ka lexuar të dhënat tuaja.

Nëse ka diçka në të dhënat tuaja që nuk e kuptoni mund të pyesni personelin mjekësor që t'ua shpjegojë. Nëse mendoni se informacioni është i saktë kjo mund të regjistrohet në dosje.

Kopje të të dhënave tuaja

Nëse doni të merrni një kopje të të dhënave tuaja këtë mund ta bëni kundrejt një pagese. Nëse opinioni i doktorit tuaj është që të dhënat të mos ju jepen, ju mund ta kundërshtoni këtë vendim duke i shkruaj gjykatës administrative të apelit në Jönköping. Nëse dëshironi që të dhënat tuaja të shkatërrohen ju mund të aplikoni për këtë tek Bordi Kombëtar i Shëndetit dhe Mirëqenies në Malmö.

Informacioni juaj personal

Në zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e Fshehtësisë (LMF) ju keni të drejtën, një herë në vit dhe pa pagesë, të shikoni çdo informacion privat që Bashkia e Rrethit mund të ketë regjistruar rreth jush. Bordi i Bashkisë së Rrethit është përgjegjës për këtë informacion. Kërkesa juaj duhet bërë me shkrim dhe me nënshkrimin tuaj. Dërgojeni atë tek Punonjësi i Mbrojtjes së të Dhënave. Nëse gjeni gabime në informacionin tuaj mund t'i kërkonti Bashkisë së Rrethit që t'i korrigjojë ato.

Pyetje

Nëse keni ndonjë pyetje rreth ligjit për të dhënat e pacientit mund të kontaktoni këshilltarin mjekësor.

Nëse keni ndonjë pyetje rreth informacionit privat mund të kontaktoni punonjësini e mbrojtjes së të dhënave. Telefononi Bashkinë e Rrethit në numrin 0470 58 80 00.

Më shumë informacion mund të gjendet në 1177.se/kronoberg dhe në sallën tuaj të pritjes.